


RAPORTI I MONITORIMIT TË INSPEKTORATIT TË PUNËS

2024





CENTER FOR POLICIES AND ADVOCACY
QENDRA PËR POLITIKA DHE AVOKIM

Autore: Rinore Rexha, Antoneta Zhjeçi

Publikuar nga: Qendra për Politika dhe Avokim

www.qpa-rks.org

cpa.kosova@gmail.com

+383 (0) 38 226 530

Data: Dhjetor 2024

Të drejtat e autorit © 2024. Qendra për Politika dhe Avokim. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

“Ky publikim është mbështetur nga Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA) përmes projektit Human Rightivism që implementohet nga Community Development Fund (CDF) dhe mbikqyrur nga Ambasada Suedeze në Kosovë.

Përgjegjësia për përmbajtjen e këtij publikimi i takon tërësisht autorëve/eve. SIDA nuk ndan domosmoshërisht pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura”.





“Monitorimi i Inspektoratit Qendror të Punës në Rajonin e Prishtinës gjatë vitit 2024”





TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	4
METODOLOGJIA.....	4
INSPEKTORATI QENDROR I PUNËS.....	6
INSPEKTORATI DHE INSPEKTORËT/ET E PUNËS NË RAJONIN E PRISHTINËS.....	6
PLANI I PUNËS	6
FUSHAT E INSPEKTIMIT.....	7
NUMRI I INSPEKTORËVE NË INSPEKTIM	8
KARTA E IDENTIFIKIMIT	8
HAPJA E INSPEKTIMIT	8
LLOJET E INSPEKTIMEVE	8
KOHËZGJATJA E INSPEKTIMEVE	9
KËRKESAT INSPEKTUESE NGA FUSHA E MARRËDHËNIES SË PUNËS.....	9
KONTRATA E PUNËS.....	9
AFATI PËR PLOTËSIMIN E DOKUMENTACIONIT	10
ORARI I PLOTË I PUNËS.....	10
LISTA E PUSHIMEVE	10
PAGA, KOMPENSIMI DHE TË ARDHURAT TJERA	11
KOMPENSIMI I LËNDIMIT NË PUNË	12
LISTA E TË PUNËSUARVE/EVE DHE LISTA E DEKLARIMEVE NË ADMINISTRATËN TATIMORE TË KOSOVËS	12
KËRKESAT INSPEKTUESE NGA FUSHA E SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË.....	13
KONTROLLAT MJEKËSORE.....	13
TRAJNIMI PËR MAKINERI TË PUNËS.....	13
ZYRTARI PËRGJEGJËS PËR SSHP	13
VLERËSIMI I RREZIKSHMËRISË PËR VENDET E PUNËS.....	14
EVIDENCA E LËNDIMEVE NË PUNË	14
RAPORTE MBI AKSIDENTET NË VENDIN E PUNËS.....	14
PAJISJET PERSONALE MBROJTËSE - PPM	15
SHËRBIMI I MBROJTJES NDAJ ZJARRIT	15





KUTIA E NDIHMËS SË PARË	16
DALJET EMERGJENTE	16
SHENJËZIMI PËR SIGURI DHE SHËNDET NË PUNË	16
PLANI I EVAKUIMIT	17
LEGJISLACIONI TJETËR.....	17
MASAT ADMINISTRATIVE	18
KUSHTET TEKNIKE NË INSPEKTORATIN QENDROR TË PUNËS.....	18
REKOMANDIME.....	23
BURIMET	26





HYRJE

Inspektorati Qendror i Punës në Kosovë ka rol kyç në ruajtjen e drejtësisë dhe sigurisë në ambientet e punës, duke siguruar zbatimin e legjislacionit të punës dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për punonjësit dhe punëdhënësit. Ky institucion, megjithatë, vazhdon të ballafaqohet me një sërë sfida dhe mangësi që ndikojnë në efektivitetin e tij. Monitorimi i kryer nga Qendra për Politika dhe Avokim ka nxjerrë në pah nevojën urgjente për një rishikim të thelluar të strukturës dhe funksionimit të Inspektoratit Qendror të Punës, në mënyrë që të rritet efikasiteti dhe të sigurohet një mbikëqyrje më e plotë dhe e mirë strukturuar e zbatimit të legjislacionit të punës.

Ky raport paraqet analizë të detajuar të monitorimit të inspektimeve në terren të Inspektoratit Qendror të Punës në Rajonin e Prishtinës për vitin 2024. Fokusi i monitorimit ka qenë i përqendruar në sektorët me rrezikshmëri të lartë, si sektori i prodhimit dhe ndërtimit, të cilat janë të njohur për nivelin e lartë të rrezikut që paraqesin për shëndetin dhe sigurinë e punonjësve, për shkak të kushteve të pasigurta dhe natyrës fizike të punës. Këta sektorë shpesh janë të ekspozuar ndaj aksidenteve dhe lëndimeve, prandaj inspektimi i këtyre aktiviteteve është shumë i rëndësishëm për garantimin e kushteve të sigurt dhe mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punonjësve.

Monitorimi i realizuar ka nxjerrë në pah nevojën për një ristrukturim të procesit të inspektimit, duke siguruar që secili inspektor të ketë një profil të qartë dhe të specializuar për fushën inspektuese. Gjithashtu, është e nevojshme të sigurohen mjete dhe instrumente të përshtatshme për inspektorët, që do të mundësojnë kryerjen e inspektimeve të thelluara dhe efikase. Rekomandimet e këtij monitorimi janë të orientuara drejt përmirësimit të planifikimit dhe organizimit të inspektimeve, përditësimit të procedurave operative dhe dokumentacionit, si dhe rritjes së kapaciteteve teknologjike për të mbështetur procesin e inspektimit. Këto masa janë të rëndësishme për të përmirësuar mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit dhe për të kontribuar në krijimin e një ambienti pune më të sigurt dhe më të drejtë për punonjësit dhe punëdhënësit në të gjithë Kosovën.

METODOLOGJIA

Gjatë vitit 2024, Qendra për Politika dhe Avokim (QPA) ka luajtur një rol të rëndësishëm në monitorimin e punës së Inspektoratit Qendror të Punës, duke mbikëqyrur 30 inspektime të realizuara në terren në Rajonin e Prishtinës. Ky rajon është zgjedhur për monitorim të thelluar për shkak të rëndësisë strategjike dhe ngarkesës së madhe që ka Inspektorati Qendror i Punës në këtë territor, si qendër kyçe ekonomike dhe administrative e Kosovës. Inspektimet janë realizuar kryesisht në sektorët me rrezikshmëri të lartë, duke përfshirë: 10 inspektime në sektorin e prodhimit, 16 në sektorin e ndërtimit dhe 4 në sektorin e arsimit, me qëllim sigurimin e një pasqyre gjithëpërfshirëse mbi zbatimin e të drejtave të punëtorëve dhe respektimin e





standardeve të sigurisë edhe në sektorët me rrezikshmëri më të ulët. Katër (4) monitorime në sektorin e arsimit janë realizuar për të mundësuar krahasimin e qasjes sektoriale së inspektorëve varësisht nga rrezikshmëria e sektorit.

Nga 30 inspektimet e monitoruara, 11 janë kryer nga inspektore gra dhe 19 nga inspektorë burra. Në kuadër të këtij angazhimi, QPA ka mbledhur dhe sistemuar të dhëna të hollësishme për secilin inspektim, duke i organizuar ato në një bazë të dhënash, e cila mundëson analizimin e lehtë dhe të thelluar të informacionit mbi inspektimet dhe gjetjet përkatëse.

Duke u mbështetur në të dhënat e grumbulluara, QPA ka realizuar një analizë gjithëpërfshirëse për të vlerësuar përputhshmërinë e praktikave të inspektimit me kornizën legjislative në fuqi. Analiza ka identifikuar shkeljet kryesore dhe sfidat më të mëdha në zbatimin e standardeve ligjore, duke ofruar një pasqyrë të qartë të gjendjes aktuale. Bazuar në gjetjet, janë formuluar rekomandime të detajuara për të përmirësuar kushtet e punës, për të forcuar përputhshmërinë ligjore dhe për të siguruar mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të punëtorëve në Kosovë.





INSPEKTORATI QENDROR I PUNËS

INSPEKTORATI DHE INSPEKTORËT/ET E PUNËS NË RAJONIN E PRISHTINËS

Roli i inspektorëve në Rajonin e Prishtinës në Inspektoratit Qendror të Punës është i shumanshëm dhe përfshin disa detyra të rëndësishme, si mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të punës, kontrollin e kushteve të sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe trajtimin e ankesave që lidhen me shkeljet e mundshme të të drejtave të punëtorëve në sektorin privat dhe atë publik. Inspektorët kanë një përgjegjësi të madhe në garantimin e sigurisë së punëtorëve dhe krijimin e kushteve të përshtatshme të punës. Ligji Nr. 03/L-212 i Punës dhe Ligji Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë përbëjnë bazën kryesore të veprimit të Inspektoratit, ndërsa një sërë ligjesh të tjera të lidhura dhe të ndërlidhura e zgjerojnë gamën e përgjegjësive, duke detyruar Inspektoratin të mbikëqyrë dhe të sigurojë zbatimin e një shtrirjeje më të gjerë të rregullave dhe standardeve të punës.

Inspektorati i Punës në Rajonin e Prishtinës përbëhet nga 22 inspektorë, prej të cilëve 14 janë burra dhe 8 gra. Megjithëse ky numër duket i mjaftueshëm, ndarja e përgjegjësive zbulon një sfidë: vetëm 14 inspektorë mbeten të disponueshëm për punën në terren, pasi pjesa tjetër trajton ankesa nga sektorët privat dhe publik. Kjo situatë rrit ngarkesën e punës për inspektorët në terren, duke ndikuar në efikasitetin dhe shpejtësinë e inspektimeve në një rajon që mbulon shtatë komuna: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliqi, Lipjan, Drenas, Graçanicë dhe Podujevë. Kuota e caktuar për çdo inspektor është 20 inspektime brenda një muaji, dhe është vërejtur gjatë monitorimeve që inspektorët realizojnë inspektime të shpejta dhe për numër, duke mos pasur kohë të mjaftueshme për inspektime të thelluara. Kjo ndikon në cilësinë e inspektimeve dhe ka reflektuar në pasqyrën e gjetjeve gjatë monitorimeve.

PLANI I PUNËS

Në kuadër të monitorimit të inspektimeve në Rajonin e Prishtinës për vitin 2024, është vënë re se Inspektorati Qendror i Punës ka një plan të përgjithshëm që mbulon të gjitha rajonet, përfshirë Rajonin e Prishtinës. Ky plan nuk është i ndarë për secilin rajon, çka do të thotë se Rajoni i Prishtinës, ashtu si rajonet e tjera, ndjekë këtë plan të përgjithshëm, pa ndarje specifike për nevojat e tij të veçanta.

Plani i punës është i strukturuar në baza mujore dhe përcakton sektorët që duhet të inspektohen në çdo periudhë. Megjithatë, gjatë monitorimit të këtij plani, janë evidentuar disa mangësi që ndikojnë në cilësinë dhe efikasitetin e inspektimeve, sidomos për Rajonin e Prishtinës. Plani përmban informacion të përgjithshëm për llojin e subjektit që do të inspektohet në secilin muaj, por ka një mungesë të dukshme në përcaktimin e kritereve dhe objektivave të qarta për secilin sektor. Kjo mungesë e detajimit e bën planifikimin të përgjithshëm dhe nuk mundëson që inspektimet të jenë të fokusuara dhe të orientuara drejt nevojave specifike të sektorëve të ndryshëm të Rajonit të Prishtinës.





Kjo mangësi mund të çojë në shpërndarje të pasaktë të burimeve dhe inspektime që nuk janë të drejtuara ndaj problematikave kryesore të sektorëve të caktuar. Pavarësisht se plani është një mjet i rëndësishëm për udhëzimin e inspektimeve, mungesa e kriterëve të qarta dhe objektivave të matshme kufizon mundësinë e inspektorëve për të realizuar një monitorim të plotë dhe efektiv.

Përmirësimi i këtij plani për vitet pasuese kërkon një strukturim më të detajuar dhe të qartë për secilin sektor, me përcaktimin e kriterëve specifikë dhe objektivave të matshme. Kjo do të mundësojë një inspektim më të saktë dhe më efektiv, duke kontribuar në përmirësimin e kushteve të punës dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve në Rajonin e Prishtinës.

Bazuar në monitorimet e inspektimeve, 13 subjekte të monitoruara gjatë inspektimit në terren kanë qenë të inspektuara nga Inspektorati Qendror i Punës në 2 vitet e fundit. Ndërsa, 17 subjekte janë inspektuar për herë të parë nga Inspektorati Qendror i Punës.

FUSHAT E INSPEKTIMIT

Në kuadër të monitorimit të veprimtarisë së Inspektoratit Qendror të Punës, është evidentuar se një inspektim realizohet në të dyja fushat, atë të marrëdhënies së punës dhe atë të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës. Inspektimi fillon me fushën e marrëdhënies së punës dhe pastaj kalon në atë të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës. Vlen të theksohet se inspektorët e punës nuk janë të profilizuar në inspektorë të specializuar për fushën e marrëdhënies së punës dhe inspektorë të specializuar për fushën e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës. Ky konstatim thekson mungesën e organizimit dhe përqendrimit në specializimin e inspektorëve sipas fushave të tyre të përgjegjësisë.

Për të adresuar këtë çështje, është hartuar dhe miratuar RREGULLORE (ZKM) Nr. 10/2024 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË AGJENCINË EKZEKUTIVE TË INSPEKTORATIT QENDROR TË PUNËS, e cila ka hyrë në fuqi më 5 shtator 2024. Kjo rregullore parasheh ndarjen e inspektorëve në dy pozita të veçanta: Inspektorë për Marrëdhënie në Punë dhe Inspektorë për Siguri dhe Shëndet në Punë. Megjithatë, implementimi i kësaj ndarjeje ende nuk është realizuar në praktikë. Kjo ka krijuar sfida në përmbushjen e detyrave specifike të inspektorëve, duke pasur parasysh që ata janë të detyruar të realizojnë inspektime për të dyja fushat gjatë një vizite në terren.

Prandaj, është thelbësore që rregullorja të fillojë implementimin sa më shpejt, për të siguruar që inspektorët të kenë fokus të qartë dhe të specializuar në fushat përkatëse të punës, duke rritur efikasitetin dhe cilësinë e inspektimeve. Implementimi i plotë i rregullores do të përmirësojë trajtimin e sfidave dhe rreziqeve të veçanta për secilën fushë dhe do të kontribuonte në forcimin e standardeve të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës.





NUMRI I INSPEKTORËVE NË INSPEKTIM

Në kontekstin e numrit të inspektorëve/eve të angazhuar/a në inspektime, vërejmë se aktualisht ky numër nuk përcaktohet me dispozita ligjore. Nga 30 monitorime të inspektimeve, shihet se në të gjitha inspektimet morën pjesë 2 inspektorë të punës.

KARTA E IDENTIFIKIMIT

Sipas Ligjit për Inspektoratin e Punës, çdo inspektor/e është i/e obliguar të pajiset dhe të paraqesë kartën e identifikimit si formë e autorizimit zyrtar për të kryer një inspektim. Nga monitorimi i 30 inspektimeve të realizuara, është vërejtur se në të gjitha rastet inspektorët/et e punës kanë prezantuar kartën e identifikimit si dokument zyrtar, duke respektuar kështu kërkesat ligjore për nisjen e procesit të inspektimit.

HAPJA E INSPEKTIMIT

Procesi i inspektimit fillon me hartimin e raportit zyrtar. Megjithatë, nga analiza e rezultateve të 30 monitorimeve të realizuara, është vërejtur mungesë e unifikimit të përdorimit të raporteve zyrtare në mënyrë konsistente. Në 23 inspektime janë përdorur raporte zyrtare në bllok indigjo, ndërsa në 7 raste të tjera janë përdorur vetëm raporte të printuara.

Një problematikë e identifikuar veçanërisht në inspektimet e sektorit të ndërtimtarisë është detyrimi i inspektorëve për të plotësuar një raport të dytë identik. Kjo ndodh në rastet kur raporti zyrtar i printuar (jo në bllok indigjo) plotësohet në vendin e inspektimit me qëllim që një kopje t'i lihet palës së inspektuar, duke krijuar një proces të dyfishtë dhe të panevojshëm, i cili zgjat kohën e inspektimit dhe shkakton duplikim të punës për inspektorët.

Gjithashtu, është vërejtur se në asnjë prej monitorimeve të inspektimeve të realizuara nuk është përdorur forma e listës kontrolluese e hartuar nga Inspektorati Qendror i Punës. Ky fakt dëshmon për një moszbatim të procedurave të standardizuara dhe sugjeron nevojën urgjente për të siguruar përdorimin e dokumentacionit zyrtar dhe të unifikuar nga inspektorët gjatë procesit inspektues, në mënyrë që të rritet efikasiteti, transparenca dhe cilësia e inspektimeve.

LLOJET E INSPEKTIMEVE

Lloji i inspektimeve nuk përcaktohet drejtpërdrejt nga dispozitat ligjore të Ligjit për Inspektoratin e Punës. Megjithatë, në praktikë, inspektorët/et e punës realizojnë inspektime të rregullta, të përsëritura, të jashtëzakonshme, ato që ndodhin si pasojë të ankesave nga palët, si dhe inspektime që lidhen me aksidente në vendin e punës.

Në kuadër të monitorimeve të realizuara, 30 inspektime kanë qenë të natyrës së rregullt. Në përputhje me sektorët që janë inspektuar, nga 30 monitorime të realizuara, 10 janë realizuar në sektorin e prodhimtarisë, 16 në sektorin e ndërtimtarisë dhe 4 në sektorin e arsimit.





KOHËZGJATJA E INSPEKTIMEVE

Gjatë procesit të monitorimit të inspektimeve të realizuara nga inspektorët/et e punës, është vërejtur se subjektet e inspektuara kryesisht kanë qenë ato me rrezikshmëri të lartë në vendin e punës, siç janë sektorët e prodhimit dhe ndërtimit. Megjithatë, numri i të punësuarve nuk ka diktuar gjithmonë kohëzgjatjen e inspektimeve, që shpesh kanë qenë shumë të shkurtra. Nga gjithsej 30 monitorime të realizuara, kohëzgjatja më e shkurtër e një inspektimi ka qenë **21 minuta**, duke përfshirë dy raste: një inspektim i rregullt dhe një inspektim i përsëritur. Nga ana tjetër, inspektimi më i gjatë ka arritur në **1 orë e 25 minuta**, i realizuar në sektorin e prodhimit si inspektim i rregullt. Kohëzgjatja mesatare e inspektimeve të realizuara është **47 minuta**.

Një çështje e rëndësishme që ka dalë në pah është kufizimi i numrit të inspektimeve që inspektorët duhet të realizojnë çdo muaj, duke pasur një kuotë prej **20 inspektimesh** për çdo inspektor. Ky numër është konsideruar i lartë dhe ka ndikim negativ në cilësinë e inspektimeve, duke i kufizuar inspektorët në kohën që mund t'u kushtojnë inspektimeve të thelluara, sidomos në sektorët me rrezikshmëri të lartë, si ndërtimtaria dhe prodhimtaria. Inspektorët janë të detyruar të përfundojnë inspektimet brenda një kohe të shkurtër për të përmbushur këtë kuotë, duke lënë pas kualitetin dhe thellësinë e inspektimeve.

Për më tepër, është vërejtur se në asnjë nga inspektimet nuk është marrë një vendim përfundimtar në vendin e inspektimit. Në të gjitha inspektimet, inspektorët kanë caktuar afate kohore për plotësimin e dokumentacionit nga ana e subjektit të inspektuar. Megjithatë, ligji nuk ndalon afatin për plotësimin e dokumentacionit, por kjo nuk duhet të bëhet praktikë e zakonshme. Në raste specifike, siç janë ato me një numër të vogël punëtorësh, vendimi mund të merret në vend, duke siguruar një reagim më të shpejtë dhe efikas. Vonesa në marrjen e vendimeve mund të çojë në mundësi për manipulimin e dokumentacionit dhe të ngadalësojë përmbushjen e detyrimeve ligjore. Një qasje më efikase dhe të drejtë do të ishte që vendimet përfundimtare të merren në vend, duke siguruar transparencën dhe rritjen e efikasitetit në procesin e inspektimit.

KËRKESAT INSPEKTUESE NGA FUSHA E MARRËDHËNIES SË PUNËS

KONTRATA E PUNËS

Kërkesa e parë nga fusha e marrëdhënies së punës është prezantimi i kontratave të punës. Në linjë me parimet e përcaktuara nga inspektorët e punës, kërkohet që subjekti në vëzhgim të paraqes një numër të caktuar të kontratave të punës të punonjësve aktual si një mostër për shqyrtim. Megjithatë, gjatë monitorimit është vërejtur se ka raste kur këto kontrata nuk kërkohen menjëherë në subjekt gjatë inspektimit. Në vend të kësaj, vendoset një afat kohor për paraqitjen fizike të tyre në zyrën e Inspektoratit Qendror të Punës në rajonin e Prishtinës, që nga inspektorët në terren njihet si "vërejtje/kërkesë për plotësimin e dokumentacionit".





AFATI PËR PLOTËSIMIN E DOKUMENTACIONIT

Me dispozitat ligjore të Ligjit për Inspektoratin e Punës nuk përcaktohet një afat specifik për plotësimin e dokumentacionit nga subjektet. Nga 30 monitorimet e realizuara, periudha mesatare kohore që inspektorët e punës kanë caktuar për plotësimin e dokumentacionit është rreth 4 ditë. Në një rast, vendimi përfundimtar i inspektorëve është marrë pas kalimit të 30 ditëve, afat i përcaktuar me Ligjin për Inspektimet. Po ashtu, një inspektim i kryer gjatë muajit shtator rezulton ende në procedurë.

ORARI I PLOTË I PUNËS

Neni 20 i Ligjit të Punës përcakton se orari i plotë i punës është dyzet (40) orë në javë. Gjatë procesit të monitorimit është evidentuar se në 18 nga 30 monitorime të realizuara, inspektorët/et e punës kanë kërkuar informacion në lidhje me orarin e plotë të punës, ndërsa në 12 raste të tjera, nuk është kërkuar informacion në lidhje me këtë dispozitë ligjore.

LISTA E PUSHIMEVE

Gjatë procesit të monitorimit, është evidentuar se në 16 nga 30 monitorime të realizuara subjektet janë kërkuar nga inspektorët e punës të paraqesin listën e pushimeve. Ndërsa në 14 raste të tjera nuk kanë kërkuar nga subjektet të paraqesin listën e pushimeve si dëshmi për respektimin e pushimit nga ana e punëdhënësve.

PUSHIMI VJETOR

Neni 32 i Ligjit të Punës përcakton dispozitat për rregullimin e pushimit vjetor. I punësuari gjatë çdo viti kalendarik ka të drejtë për pushim vjetor të paguar në një kohëzgjatje prej së paku katër (4) javë, pavarësisht a punon me orar të plotë apo të shkurtuar.

Në 18 nga 30 raste të monitoruara, inspektorët e punës kanë kërkuar informacion në lidhje me shfrytëzimin e pushimit vjetor të punonjësve. Ndërsa, në 12 raste të tjera nuk është kërkuar informacionin për këtë dispozitë ligjore.

Neni 34 i Ligjit të Punës përcakton dispozitat për rregullimin e pushimit vjetor në ditën e festave zyrtare. Festat zyrtare që bien në ditë pune, sipas Ligjit për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës, nuk llogariten ditë të pushimit vjetor.

Vlen të theksohet, se në rolin e këshillëdhënësve inspektorët e punës në subjektet ku kanë inspektuar aspektin e pushimit në ditët e festave zyrtare gjithnjë kanë informuar punëdhënësit dhe punonjësit që puna në ditët e festave zyrtare nuk ndalohet me legjislacion, mirëpo ekzistojnë dispozitat ligjore që rregullojnë kompensimin e pagës për punën në ditë të festave zyrtare.

Në vetëm 7 nga 30 monitorimet e realizuara, inspektorët e punës kanë kërkuar dëshmi për pushimin gjatë ditëve të festave zyrtare.





PUSHIMI JAVOR

Neni 31 i Ligjit të Punës përcakton dispozitat për rregullimin e pushimit javor.

I punësuar ka të drejtë në pushim javor në kohëzgjatje prej së paku njëzet e katër (24) orë pandërprerë. I punësuar nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç ka të drejtë në pushim javor në kohëzgjatje prej së paku tridhjetë e gjashtë (36) orë pandërprerë. Nëse të punësuarit i duhet të punojë në ditën e pushimit javor, atij duhet t'i sigurohet një ditë pushimi gjatë javës së ardhshme. E drejta për shfrytëzimin e pushimit javor është një nga çështjet e para për të cilat inspektorët e punës duhet të interesohen gjatë inspektimit të një subjekti.

Në 20 nga 30 monitorimet e realizuara inspektorët e punës kanë kërkuar dëshmi për shfrytëzimin e pushimit javor nga punëdhënësit në pajtim me legjislacionin e punës.

PUSHIMI I LEHONISË

Neni 49 i Ligjit të Punës përcakton dispozitat për rregullimin e pushimit të lehonisë.

Gruaja e punësuar ka të drejtën të përfitojë një periudhë pushimi prej dymbëdhjetë (12) muajsh në lidhje me lehoninë.

Nga 30 monitorimet e realizuara, 12 subjekte rezultuan me gra të punësuar. Në 2 nga 12 subjektet e inspektuara me gra të punësuar, inspektorët e punës kanë kërkuar nga subjektet të paraqesin dëshmi në lidhje me zbatimin e të drejtës së punonjëseve për të përfituar nga pushimi i lehonisë. Ndërsa në 10 raste të tjera nuk kanë kërkuar informacion për këtë dispozitë ligjore.

PUSHIMI MJEKËSOR

Neni 59 i Ligjit të Punës përcakton dispozitat për rregullimin e pushimit mjekësor dhe kompensimin e tij.

I punësuar në rast të sëmundjes ka të drejtë në pushim mjekësor të rregullt mbi bazën, deri në njëzet (20) ditë pune brenda një (1) viti me kompensim prej 100 % të pagës. Në 3 nga 30 monitorimet e realizuara inspektorët e punës kanë kërkuar të informohen nëse punonjësit shfrytëzojnë të drejtën e pushimit mjekësor, ndërsa në vetëm 2 nga 30 subjektet e inspektuara inspektorët janë interesuar nëse shfrytëzimi i këtij pushimi kompensohet siç përcaktohet nga dispozitat ligjore.

PAGA, KOMPENSIMI DHE TË ARDHURAT TJERA

Neni 55 i Ligjit të Punës përcakton dispozitat për pagën, kompensimet dhe të ardhurat e tjera. I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në përputhje me ligjin, Kontratën Kolektive dhe Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit. Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuar i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës.





Në 20 nga 30 monitorimet e realizuara, inspektorët e punës kanë kërkuar të informohen nëse punonjësit kanë pagë të rregullt.

Neni 57 i Ligjit të Punës përcakton dispozitat për Pagën minimale. Qeveria e Kosovës në fund të çdo viti kalendarik përcakton pagën minimale sipas propozimit të Këshillit Ekonomiko-Social. Në raport me këtë dispozitë, në vetëm 7 nga 30 monitorimet e realizuara, inspektorët e punës kanë kërkuar të informohen nëse në subjekt ka punonjës me pagë minimale.

KOMPENSIMI I LËNDIMIT NË PUNË

Neni 60 i Ligjit të Punës përcakton dispozitat për Kompensimin e lëndimit në punë. Punëdhënësi është i obliguar që në rast të lëndimeve dhe sëmundjeve profesionale të të punësuarit, të marra gjatë kryerjes së punës, t'ju ofrojë sigurimin për kompensimin e shpenzimeve sipas këtij ligji dhe ligjeve tjera të aplikueshme.

Në vetëm 1 nga 30 monitorimet e realizuara, inspektorët e punës kanë kërkuar të informohen nëse punonjësve që kanë pësuar lëndim, apo aksident në vendin e punës u është kompensuar dëmi.

LISTA E TË PUNËSUARVE/EVE DHE LISTA E DEKLARIMEVE NË ADMINISTRATËN TATIMORE TË KOSOVËS

Lista e të punësuarve në subjekt dhe lista e deklarimeve në Administratën Tatimore të Kosovës janë dy nga kërkesat më të shpeshta të inspektorëve të punës gjatë inspektimit të një subjekti, me anë të së cilës inspektorët identifikojnë numrin e punonjësve aktual në atë subjekt, si dhe vërtetojnë se për të njëjtët punëdhënësi është duke kryer obligimin tatimor pranë Administratës Tatimore të Kosovës.

Në 27 nga 30 monitorimet e realizuara inspektorët e punës kanë kërkuar të paraqiten këto lista, ndërsa në 3 raste të tjera nuk është kërkuar ky dokumentacion.





KËRKESAT INSPEKTUESE NGA FUSHA E SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË

KONTROLLAT MJEKËSORE

Neni 22 i Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë përcakton dispozitat për kontrollat mjekësore. Punëdhënësi është i detyruar t'iu sigurojë të punësuarve kontrolle mjekësore në institucionet shëndetësore të licencuara për shërbime nga mjekësia e punës. Punëdhënësi është i detyruar t'i dërgojë në kontrollim mjekësor të gjithë të punësuarit së paku një herë në tre (3) vite.

Në 22 nga 30 monitorimet e realizuara inspektorët e punës kanë kërkuar dëshmi për kontrollat mjekësore për të cilat lëshohen certifikatat mjekësore nga institucione shëndetësore të licencuara për shërbime të tilla.

TRAJNIMI PËR MAKINERI TË PUNËS

Neni 20 i Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë përcakton dispozitat për trajnimin e të punësuarve.

Punëdhënësi përkujdeset që secili i punësuar të trajnohet nga siguria dhe shëndeti në punë, për vendin e tij të punës si: para ose pas themelimit të marrëdhënies së punës; në rast të transferimit apo ndërrimit të vendit të punës; në rast të paraqitjes së pajisjeve të reja apo ndërrimit të pajisjeve të punës; në rast të përdorimit të teknologjisë së re; kohë pas kohe nëse është e domosdoshme.

Punëdhënësi përkujdeset që të punësuarit e subjektit të kontraktuar të marrin udhëzimet adekuate për sigurinë dhe shëndetin në punë gjatë aktivitetit të tyre në subjektin e tij.

Në 13 nga 30 monitorimet e realizuara inspektorët e punës kanë kërkuar të informohen nëse punonjësit kanë trajnimin e duhur për makinerinë e punës në të cilën janë të angazhuar.

ZYRTARI PËRGJEGJËS PËR SSHP

Neni 10 i Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë, në varësi të numrit të të punësuarve në subjekt përcakton të punësuarin e ngarkuar për siguri dhe shëndet në punë.

Punëdhënësi i cili punëson deri në pesëdhjetë (50) të punësuar, nëse është i aftë/kompetent, mund të marrë vetë përgjegjësinë për zbatimin e masave të përcaktuara me këtë ligj.

Punëdhënësi i cili punëson mbi pesëdhjetë (50) e më pak se dyqindpesëdhjetë (250) të punësuar, është i detyruar të caktojë një ekspert, për kryerjen e detyrave nga siguria dhe shëndeti në punë.

Punëdhënësi i cili punëson më shumë se dyqind e pesëdhjetë (250) të punësuar duhet të angazhojë një (1) ose më shumë ekspert për kryerjen e detyrave nga siguria dhe shëndeti në punë.





Në 9 nga 30 monitorimet e realizuara, inspektorët e punës kanë kërkuar të informohen nëse subjekti ka të punësuar persona përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë në raport me numrin e të punësuarve në atë subjekt.

VLERËSIMI I RREZIKSHMËRISË PËR VENDET E PUNËS

Neni 16 i Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë.

Punëdhënësi është i detyruar të bëjë vlerësimin e rrezikshmërisë për vendet e punës, me qëllim të parandalimit të rrezikut, përfshirë dhe ekspozimin e të punësuarve nga elementet e dëmshme dhe të rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë në punë gjatë procesit të punës. Vlerësimi i rrezikshmërisë për vendet e punës bëhet nga profesionistë të fushave përkatëse brenda subjektit punues të caktuar nga punëdhënësi, përkatësisht nga shërbimet e jashtme ose personat e kontraktuar nga punëdhënësi.

Punëdhënësi, pas procesit të vlerësimit të rrezikshmërisë, është i detyruar të hartojë dokumentin e vlerësimit të rrezikshmërisë dhe të ndërmarrë masat mbrojtëse të domosdoshme për sigurinë dhe shëndetin në punë të të punësuarve. Mënyra e përgatitjes së dokumentit për vlerësimin e rrezikut, përmbajtja e tij si dhe të dhënat mbi të cilat duhet të bazohet vlerësimi i rrezikut, rregullohen me akt nënligjor, të nxjerrë nga Ministria, në pajtim me ministrinë kompetente për çështjet e shëndetësisë.

Në vetëm 9 nga 30 monitorimet e realizuara, inspektorët e punës kanë kërkuar të informohen nëse subjekti ka dokumentin e vlerësimit të rrezikshmërisë për vendet e punës.

EVIDENCA E LËNDIMEVE NË PUNË

Neni 16 i Ligjit për Siguri dhe Shëndet në punë përcakton dispozitat për evidencën e lëndimeve në punë.

Punëdhënësi është i detyruar të mbajë evidencën për lëndime në punë, sëmundjet profesionale dhe të pajisë të lënduarin me fletë lëndim në vend të punës.

Nga 30 monitorime të realizuara, në vetëm në 1 raste inspektorët e punës kanë kërkuar të informohen nëse subjekti ka një evidencë të tillë.

RAPORTE MBI AKSIDENTET NË VENDIN E PUNËS

Neni 16 i Ligjit për Siguri dhe Shëndet në punë përcakton dispozitat për raportet mbi aksidentet në vendin e punës.





Punëdhënësi është i detyruar që në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse për siguri dhe shëndet në punë, të hartojë raporte mbi aksidentet dhe sëmundjet profesionale në subjektin e tij të punës.

Nga 30 monitorimet e realizuara, në asnjë nga subjektet e monitoruara inspektorët e punës nuk kanë kërkuar të informohen nëse subjekti ka raporte individuale mbi aksidentet në vendin e punës.

PAJISJET PERSONALE MBROJTËSE - PPM

Neni 13 i Ligjit për Siguri dhe Shëndet në punë përcakton dispozitat për pajisjet personale mbrojtëse.

Punëdhënësi detyrohet të zbatojë masa për parandalimin e aksidenteve në punë dhe të sëmundjeve profesionale, duke siguruar pajisjet mbrojtëse individuale, të sigurojë mirëmbajtjen e tyre dhe të respektojë afatet e skadimit të përdorimit të tyre.

Në 15 nga 30 monitorimet e realizuara inspektorët e punës kanë kërkuar të informohen nëse punonjësit janë të pajisura me pajisje personale mbrojtëse në tërësi. Pajisjet personale mbrojtëse specifikohen në:

1. Pajisje mbrojtëse për kokën (për të cilën inspektorët e punës kanë kërkuar të informohen në 14 nga 30 monitorimet e realizuara);
2. Pajisjet mbrojtëse për dëgjim (për të cilën inspektorët e punës kanë kërkuar të informohen në 12 nga 30 monitorimet e realizuara);
3. Pajisjet mbrojtëse për frymëmarrje (për të cilën inspektorët e punës kanë kërkuar të informohen në 6 nga 30 monitorimet e realizuara);
4. Pajisje mbrojtëse për krah dhe duar (për të cilën inspektorët e punës kanë kërkuar të informohen në 5 nga 30 monitorimet e realizuara);
5. Pajisjet mbrojtëse për lëkurë (për të cilën inspektorët e punës kanë kërkuar të informohen në 6 nga 30 monitorimet e realizuara);
6. Pajisjet mbrojtëse për trung dhe bark (për të cilën inspektorët e punës kanë kërkuar të informohen në 4 nga 30 monitorimet e realizuara); dhe
7. Pajisjet mbrojtëse për të gjithë trupin (për të cilën inspektorët e punës kanë kërkuar të informohen në 4 nga 30 monitorimet e realizuara).

Ndërsa sa i përket certifikimit të pajisjeve personale mbrojtëse, vetëm në 4 nga 30 inspektimet e monitoruara inspektorët e punës kanë kërkuar informacion mbi këtë çështje.

SHËRBIMI I MBROJTJES NDAJ ZJARRIT





Neni 13 i Ligjit për Siguri dhe Shëndet në punë përcakton dispozitat për vendosjen e shërbimit për mbrojtje ndaj zjarrit.

Punëdhënësi është i detyruar të zbatojë masa për parandalimin e aksidenteve në punë dhe të sëmundjeve profesionale.

Punëdhënësi është i obliguar të sigurojë numër të mjaftueshëm të aparateve për fikjen e zjarrit dhe të njëjtat të jenë me mbushje adekuate sipas llojit të shkaktarit të zjarrit; t'i mbajë në gjendje të rregullt dhe t'i rimbushë në afate të caktuara të cilat shënohen në tiketën e vendosur në aparat; t'i vendos në vende të përshtatshme aparatet për fikjen e zjarrit; t'i instalojë hidrantë në subjektet punuese ku ka rrezik të shtuar për shpërthimin e zjarrit dhe ku konsiderohet që aparatet për fikjen e zjarrit nuk janë të mjaftueshme si dhe t'i vendos hidrantët në vende të dukshme, të përshtatshme dhe duhet të jenë në gjendje të rregullt për përdorim në çdo kohë.

Në 12 nga 30 inspektimet e monitoruara, inspektorët e punës kanë kërkuar dëshmi për posedimin dhe vendosjen e duhur të shërbimit të mbrojtjes ndaj zjarrit.

KUTIA E NDIHMËS SË PARË

Neni 11 i Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë përcakton dispozitat për ndihmën e parë, fikjen e zjarreve, evakuimin e të punësuarve, rreziqet serioze dhe të mundshme.

Punëdhënësi është i detyruar të ndërmarrë masat e nevojshme për ndihmën e parë, fikjen e zjarrit dhe evakuimin e të punësuarve, të përshtatura sipas natyrës së aktiviteteve dhe madhësisë së subjekteve punuese, si dhe është i detyruar të organizojë dhe t'i ofrojë ndihmën e parë të punësuarve në rast të lëndimit në punë ose sëmundjeve të papritura dhe të sigurojë përcjelljen e tyre për trajtim mjekësor.

Në 13 nga 30 inspektimet e monitoruara, inspektorët e punës kanë kërkuar dëshmi për posedimin dhe vendosjen në mënyrë të duhur të kutisë së ndihmës së parë.

DALJET EMERGJENTE

Neni 15 i Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë obligon punëdhënësin se secila ndërtesë duhet të ketë dalje emergjente.

Në raport me këtë obligim ligjor, në 6 nga 30 monitorimet e realizuara, inspektorët e punës kanë kërkuar të informohen nëse subjekti ka përmbushur obligimin për posedimin e daljeve emergjente.

SHENJËZIMI PËR SIGURI DHE SHËNDET NË PUNË

Neni 13 i Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë, detyron punëdhënësin të ndërmarrë masat për të siguruar materialet e nevojshme për informimin dhe trajnimin e të punësuarve dhe të vendosë shenja adekuate për siguri, postera, fletushka, filma, filmime të lidhura me sigurinë dhe shëndetin në punë.





Në 15 nga 30 monitorimet e realizuara, inspektorët e punës kanë kërkuar nga subjektet të ofrojnë dëshmi në lidhje me shenjëzimin për sigurinë dhe shëndetin në punë.

PLANI I EVAKUIMIT

Neni 11 i Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë obligon punëdhënësin që të hartoj një plan për evakuim dhe shpëtim në situata emergjente, plan të cilin i'a bën të ditur të gjithë të punësuarve, si dhe kryen ushtrime praktike, të paktën një herë në dy (2) vjet, në përputhje me këtë plan.

Në 2 nga 30 monitorimet e realizuara, inspektorët e punës kanë kërkuar të informohen nëse subjekti ka plan për evakuimin e punonjësve në rastet kur kërkohet një gjë e tillë.

LEGJSLACIONI TJETËR

Zbatimi i Ligjit për Kontrollin e Duhanit- Në kompetencat e Inspektoratit Qendror të Punës përfshihet edhe mbikëqyrja e zbatimit të paragrafit 3 të nenit 10 dhe paragrafëve 1.2 dhe 3.2 të nenit 11 të Ligjit për Kontrollin e Duhanit. Megjithatë, nga 30 monitorime të inspektimeve të realizuara, nuk është evidentuar asnjë rast ku është mbikëqyrur zbatimi i këtij ligji.

Zbatimi i Ligjit për Greva dhe Ligjit për Organizim Sindikal- Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Greva dhe Ligjit për Organizim Sindikal bën pjesë në përgjegjësitë e Inspektoratit e Inspektoratit Qendror të Punës. Nga 30 monitorime të inspektimeve të realizuara, nuk është konstatuar asnjë rast mbikëqyrjeje në këtë drejtim.

Zbatimi i Ligjit për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara- Mbikëqyrja e zbatimit të këtij ligji është realizuar në përputhje me kërkesat e kornizës ligjore, e cila obligon çdo punëdhënës të punësojë një person me aftësi të kufizuara për çdo pesëdhjetë (50) punëtorë.

Zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve- Mbikëqyrja e zbatimit të këtij ligji nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e kornizës ligjore, e cila obligon çdo punëdhënës privat me më shumë se pesëdhjetë (50) punëtorë të caktojë një zyrtar përgjegjës për trajtimin e sinjalizimeve. Rrjedhimisht, mbikëqyrja e zbatimit të këtij ligji nuk është realizuar në asnjë nga rastet e inspektimeve të monitoruara, ku subjekti ka kaluar numrin e 50 punëtorëve.

Këto gjetje theksojnë nevojën për një angazhim më të madh në mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre ligjeve, duke përmirësuar proceset e inspektimit dhe monitorimit.





MASAT ADMINISTRATIVE

Masat administrative të ndërmarra nga Inspektorati Qendror i Punës janë një pjesë e rëndësishme e procesit të mbikëqyrjes dhe sigurisë në vendin e punës, me qëllim garantimin e respektimit të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi. Këto masa synojnë ndihmën për përmirësimin e kushteve të punës dhe krijimin e një mjedisi të sigurt për punonjësit.

Gjatë vitit 2024, nga 30 monitorime të inspektimeve të realizuara në Rajonin e Prishtinës, është evidentuar se 4 subjekte janë vlerësuar me masë administrative "Pa vërejtje", ndërsa 16 subjekte të tjera fillimisht kanë marrë "Vërejtje" dhe janë udhëzuar për plotësimin e dokumentacionit dhe për paraqitjen e tij në zyrat e Inspektoratit Qendror të Punës në Rajonin e Prishtinës. 10 inspektime janë përmbyllur me masën administrative të "Ndalimit/pezullimit të punimeve" deri në sigurimin e kushteve të nevojshme për sigurinë në punë. 11 subjekte janë gjorbitur për shkak se nuk kanë ndërmarrë masat e kërkuara për përmirësimin e kushteve të punës, pavarësisht këshillave të dhëna nga inspektorët. Prej këtyre, vetëm 3 gjoba janë paguar deri më tani.

KUSHTET TEKNIKE NË INSPEKTORATIN QENDROR TË PUNËS

Gjatë monitorimit të Inspektoratit Qendror të Punës në Rajonin e Prishtinës, janë identifikuar disa sfida dhe mangësi në kushtet teknike, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në efikasitetin e inspektimeve dhe në sigurinë e punës. Më poshtë janë disa prej çështjeve kryesore të evidentuara:

Mungesa e pajisjeve personale mbrojtëse (PPM)

- Inspektorët që kryejnë vizita në terren, veçanërisht në sektorët me rrezikshmëri të lartë, si ndërtimtaria dhe prodhimtaria (të cilët kanë qenë edhe subjekt i monitorimit), të gjithë nuk disponojnë pajisjet e nevojshme mbrojtëse në terren.

Mungesa e pajisjeve për mbrojtjen nga rrezikshmëria e lartë e substancave të dëmshme, dhe ato për mbrojtje ndaj rreziqeve fizike (si helmetat dhe këpucët e sigurt) e vështirëson realizimin e inspektimeve të sigurt. Gjithashtu, mungesa e pajisjeve për matjen e nivelit të zhurmës në ambientet e punës, si dhe matësit për kimikatet e dëmshme, ka bërë që shumë subjekte të mos vlerësohen në mënyrë të duhur për kushtet e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Mungesa e mjeteve të transportit

- Inspektorati Qendror i Punës në Rajonin e Prishtinës aktualisht ka vetëm 3 automjete zyrtare, numër ky i pamjaftueshëm për të mbuluar të gjitha inspektimet e nevojshme në rajon.

Kjo mangësi i kufizon mundësitë e inspektorëve për të realizuar vizita të rregullta dhe në kohë në terren, duke ngadalësuar procesin e inspektimit dhe duke e bërë të vështirë arritjen e kuotës prej 20 inspektimeve në muaj për një (1) inspektor/e.





Mungesa e digjitalizimit të proceseve në Inspektoratin Qendror të Punës

- Një tjetër problem i evidentuar është mungesa e digjitalizimit të të dhënave dhe proceseve administrative të Inspektoratit Qendror të Punës. Aktualisht, të dhënat nga inspektimet vazhdojnë të mbahen manualisht, e që është pengesë e madhe për menaxhimin efikas të informacionit dhe për sigurimin e një raportimi në kohë.

Një sistem i integruar digjital mund të përmirësonte efikasitetin e procesit, duke mundësuar regjistrimin dhe ndarjen e shpejtë të informacionit dhe për monitorim në kohë reale.

Mungesa e materialeve dhe pajisjeve shtesë për inspektim

- Inspektorët e punës përballen me mungesën e materialeve shtesë për realizimin e inspektimeve të plota, si mjetet për matjen e temperaturës, pajisjet për kontrollin e cilësisë së ajrit, dhe pajisjet për vlerësimin e kushteve të ndriçimit në ambientet e punës.

Këto pajisje janë thelbësore për të siguruar një vlerësim të saktë dhe të plotë të kushteve të punës, dhe mungesa e tyre ndikon në cilësinë e inspektimeve.

Mungesa e kushteve të duhura për mbajtjen e pajisjeve dhe materialeve

- Inspektorët e punës nuk kanë kushte të përshtatshme për mbajtjen e pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për inspektimet në terren. Mungesa e hapësirave të mjaftueshme për ruajtjen e pajisjeve dhe materialeve të mbrojtjes, ka bërë që ato të jenë të paorganizuar dhe të dëmtohen gjatë përdorimit.

Përdorimi i telefonave personalë për inspektimet në terren

- Për shkak të mungesës së pajisjeve të specializuara për inspektim dhe dokumentim, inspektorët janë të detyruar të përdorin telefonat e tyre personalë për të regjistruar foto të subjekteve që inspektojnë. Këto foto shërbejnë si prova dhe dokumente të bashkangjitura në raportet e inspektimeve.

Ky proces është i papërshtatshëm dhe jo i sigurt për ruajtjen e të dhënave. Gjithashtu, përdorimi i telefonave personalë mund të ndikojë në efikasitetin e inspektimeve në terren dhe të krijojë një nivel të ulët të profesionalizmit dhe sigurisë në regjistrimin e informacionit.

KRAHASIMI ME VITET PARAPRAKE

Gjatë vitit 2022 dhe 2023, Qendra për Politika dhe Avokim ka monitoruar inspektimet në terren të Inspektoratit të Punës dhe ka përpiluar raportin e monitorimit ku ka listuar gjetjet dhe



rekomandimet¹. Më poshtë janë listuar të gjeturat që rezultojnë nga puna e Inspektoratit të Punës në krahasim me vitet paraprake ku QPA ka monitoruar këtë institucion.

Statuti në këtë tabelë paraqet progresin e bërë nga institucionet në drejtim të përmbushjes së rekomandimeve nga raportet e QPA-së. Nivelet e progresit janë të ndara në: Regres, nuk ka progres, progres i ulët, progres i limituar, ka progres, dhe progres i dukshëm.

Kapitulli	Të gjeturat 2022-2023	Të gjeturat 2024	Statuti
Fushat e inspektimit	Inspektimi realizohet në të dy fushat, atë të marrëdhënies së punës, dhe atë të sigurisë dhe shëndetit në punë. Inspektorët nuk janë të profilizuar dhe të ndarë në bazë të fushave.	Është hartuar dhe miratuar "RREGULLORE (ZKM) Nr. 10/2024 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË AGJENCINË EKZEKUTIVE TË INSPEKTORATIT QENDROR TË PUNËS" që bënë ndarjen e inspektorëve në fusha, mirëpo ende nuk ka gjetur zbatim të plotë në praktikë.	Ka progres
Numri i inspektorëve në inspektim	Nga 60 monitorime të inspektimeve, në 17 prej tyre merr pjesë vetëm një (1) inspektor/e, që paraqet sfida në shtrirjen dhe thellësinë e inspektimit.	Nga 30 monitorime të inspektimeve, në të gjitha marrin pjesë dy (2) inspektorë/e	Progres i dukshëm
Karta e identifikimit	Nga 60 monitorime të inspektimeve, në 25 raste inspektori/ja i/e punës nuk ka paraqitur fizikisht kartën e identifikimit	Nga 30 monitorime të inspektimeve, të gjithë inspektorët/et kanë paraqitur fizikisht kartën e identifikimit	Progres i dukshëm
Legjislacioni tjetër	Inspektorati i punës mbikqyr edhe zbatimin e legjislacionit tjetër përveq legjislacioni të punës. Më poshtë janë paraqitur të gjeturat se	Në vitin 2024 legjislacioni tjetër, përvq ligjit për aftësim, riaftësim profesional dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara, nuk është	Regres

¹ Zheqij Antoneta, Rexha Rinore. Qendra për Politika dhe Avokim. 2023. <https://qpa-rks.org/wp-content/uploads/2023/12/Final-Report.pdf>



	<p>sa kanë përmbushur monitorimin e këtij legjislacioni, nga 60 inspektime:</p> <p>Ligji për Kontrollin e Duhanit – 26% të rasteve</p> <p>Ligji për Greva dhe Ligji për Organizim Sindikal – 4% të rasteve</p> <p>Ligji për Aftësim, riaftësim profesional, dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara – 30% të rasteve</p> <p>Ligji për Mbrojtje të Sinjalizuesve – 26% të rasteve</p>	mbikqyrur në asnjë rast nga Inspektorati i Punës	
Kushtet teknike në Inspektoratin e Punës	<p>Përgjatë monitorimeve 2022-2023 janë vërejtur këto mungesa:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zyre të përshtatshme veçanërisht në rajonin e Prishtinës - Mungesa e pajisjeve personale mbrojtëse për inspektorët/et e punës - Mungesa e veturave zyrtare dhe amortizimi i veturave zyrtare ekzistuese - Mungesa e digjitalizimit të proceseve të punës - Mungesa e materialeve 	<p>Kushtet teknike në 2024 janë matur vetëm për rajonin e Prishtinës dhe vërejmë që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ky rajon është bartur në lokacion të ri me më shumë hapësirë funksionale por që ende nuk janë kushtet e duhura për mbarëvajtje të punës, ndonëse ka përmirësim me vitet paraprake - Ka rritje të numrit të pajisjeve personale mbrojtëse për inspektorë/e të punës por ende ka mungesa që vështirësojnë realizimin e inspektimeve në sektorë me 	Progres limituar i





	<p>dhe pajisjeve për inspektim (si mjetet për matje të cilësisë së ajrit, pajisjet për vlerësimin e kushteve të ndriçimit etj.)</p>	<p>rrezikshmëri të lartë</p> <ul style="list-style-type: none">- Rajoni i Prishtinës ka ende probleme me numrin e veturave përderisa vetëm tre (3) vetura janë funksionale në këtë rajon.- Digjitalizimi si proces ka filluar duke u bërë prokurimi i pajisjeve, softuerit, dhe poashtu pilotimi i tij, por ende nuk është vënë në implementim të plotë- Materialet dhe pajisjet për inspektim janë blerë mirëpo ka mungesë të sasisë totale të tyre. Ndonëse krahasuar me vitet e kaluara kur nuk kanë qenë far në dispozicion kjo paraqet një progres të lartë. <p>-</p>	
--	---	--	--



REKOMANDIME

1. Hartimi i Ligjit të ri për Inspektoratin Qendror të Punës

Monitorimi i inspektimeve në terren ka konstatuar si nevojë urgjente miratimi e Ligjit të ri për Inspektoratin Qendror të Punës, për të garantuar qartësi dhe për të mundësuar funksionimin e duhur të Inspektoratit Qendror të Punës. Kjo do të ndihmojë në forcimin e kapaciteteve dhe efikasitetit të këtij organi, duke siguruar mbrojtje të të drejtave të punonjësve/eve dhe duke kontribuar në zhvillimin e një mjedisi të shëndetshëm, të drejtë dhe të barabartë për të gjithë të punësuarit/at.

2. Implementimi në praktikë i Rregullores për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Inspektoratin Qendror të Punës

Në përputhje me Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, Inspektorati Qendror i Punës është i obliguar që nga viti 2019, të hartojë rregullore për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. Pavarësisht miratimit të rregullores në vitin 2024, më 5 shtator, procesi i implementimit të saj në praktikë ende nuk ka filluar. Për të përmirësuar efikasitetin në punë dhe për të përmbushur kërkesat ligjore, është e domosdoshme që implementimi i rregullores të fillojë sa më shpejt. Ky implementim do të kontribuonte në përmirësimin e organizimit të brendshëm, rritjen e efikasitetit të punës dhe përmbushjen e kërkesave ligjore të përcaktuara nga legjislacioni.

3. Hartim më i detajuar i planit të punës dhe publikimi i tij

Në kuadër të monitorimit të inspektimeve në Rajonin e Prishtinës, është vërejtur se plani aktual i punës i Inspektoratit Qendror të Punës është i përgjithshëm dhe nuk adreson nevojat specifike të secilit rajon, përfshirë Rajonin e Prishtinës. Ky plan nuk ka kriteret e qarta dhe objektiva të matshme për secilin sektor, duke e kufizuar efikasitetin e inspektimeve.

Për të përmirësuar këtë, rekomandohet që plani i punës për vitin pasues të hartohet për çdo rajon, duke përfshirë specifikime të detajuara për secilin sektor, me kriteret dhe objektiva të qarta për inspektime. Gjithashtu, për të siguruar transparencën, plani duhet të publikohet në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror të Punës.

4. Zbatimi efektiv i strukturës së inspektorëve

Aktualisht, në Rajonin e Prishtinës, inspektorët e punës janë të ndarë në tri kategori kryesore: inspektorë të punës në terren, inspektorë për trajtimin e ankesave nga sektori privat dhe inspektorë për trajtimin e ankesave nga sektori publik. Kjo ndarje nuk është në përputhje me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Inspektoratin Qendror të Punës, e cila parashikon një strukturë tjetër.

Sipas rregullores, inspektorët duhet të ndahen në dy profile specifike: inspektorë për marrëdhëniet e punës dhe inspektorë për siguri dhe shëndet në punë. Kjo ndarje synon të rrisë



specializimin dhe efikasitetin e inspektorëve në fushat e tyre përkatëse, duke siguruar fokus të qartë dhe përmirësuar cilësinë dhe thellësinë e inspektimeve në terren. Në përputhje me këtë, trajtimi i ankesave duhet të integrohet brenda këtyre profileve, duke siguruar që çdo inspektor të trajtojë ankesat në përputhje me fushën e tij të specializimit.

Rekomandohet që ndarja e inspektorëve të bëhet në përputhje të plotë me rregulloren në fuqi dhe të zbatohet në mënyrë efektive. Ky harmonizim do të kontribuojë në konsistencën dhe profesionalizmin e procesit të inspektimit, duke përmirësuar mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të punës dhe standardeve të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës. Zbatimi i plotë i rregullores do të sigurojë një strukturë të qëndrueshme dhe të orientuar drejt përmbushjes së misionit të Inspektoratit të Punës.

5. Digjitalizimi i inspektimeve në Inspektoratin Qendror të Punës

Rekomandohet digjitalizimi i inspektimeve të Inspektoratit Qendror të Punës në terren. Bazuar në monitorimin e inspektimeve në Rajonin e Prishtinës, konsiderohet se ky transformim do të sjellë një lehtësim të theksuar në detyrat e inspektorëve/eve të punës dhe do të ndikojë pozitivisht në efikasitetin dhe shpejtësinë e inspektimeve. Përdorimi i teknologjive digjitale për regjistrimin, dokumentimin dhe raportimin e inspektimit do të optimizojë procesin, duke lehtësuar kuptimin dhe analizën e të dhënave. Kjo do të rezultojë në një koordinim më efikas mes inspektorëve/eve dhe një përgjigje më të shpejtë ndaj sfidave dhe nevojave emergjente gjatë inspektimeve. Ky investim në digjitalizim do të kontribuojë në përmirësimin e përgjithshëm të punës së Inspektoratit të Punës dhe do të ndihmojë në përmbushjen e qëllimeve të tij të përgjithshme.

6. Zhvillimi i metodologjisë standarde në procedurat e inspektimit

Të unifikohen raportet zyrtare për të gjithë inspektorët/et e punës. Krijimi i një metodologjie të standardizuar në procedurat inspektuese, si dhe gjatë identifikimit të shkeljeve në subjektin inspektues, synon të sigurojë konsistencë dhe objektivitet në të gjithë procesin e inspektimit. Rëndësia kryesore e kësaj përpjekje është eliminimi i kërkesave të ndryshme të paraqitura në subjektet e ngjashme inspektuese nën inspektimin e Inspektoratit Qendror të Punës.

7. Të rishikohet kuota prej 20 inspektime në muaj për një inspektor/e

Rekomandohet që kuota e inspektimeve për çdo inspektor në Rajonin e Prishtinës të rishikohet dhe të rregullohet në mënyrë të detajuar, duke u bazuar në analizën e kushteve aktuale të punës dhe kërkesave të sektorëve të ndryshëm. Aktualisht, kuota prej 20 inspektimesh për çdo inspektor është e vendosur si një numër fiks dhe i njëjtë për të gjitha rajonet, duke përfshirë edhe Rajonin e Prishtinës, pa marrë parasysh kompleksitetin dhe rrezikshmërinë e sektorëve të inspektuar. Ky numër i lartë i inspektimeve ka krijuar një ngarkesë të madhe për inspektorët, duke sjellë si rezultat inspektime në kohë të shkurtër, pa mundësinë për një analizë të detajuar të kushteve të punës dhe pa siguruar një inspektim të thelluar. Kjo ka ndikuar negativisht në





cilësinë e inspektimeve, duke favorizuar sasinë në vend të thellësisë dhe përputhshmërisë me standardet ligjore dhe të sigurisë.

Po ashtu, një kuotë e rregulluar mund të ndihmonte në uljen e presionit mbi inspektorët dhe përmirësimin e efikasitetit në realizimin e inspektimeve të plota dhe të thelluara.

Për më tepër, rekomandohet që të fillohet me marrjen e një vendim përfundimtar në vendin e inspektimit për rastet specifike siç janë subjektet me një numër të vogël punëtorësh, në mënyrë që të sigurohet reagimi i menjëhershëm dhe efikas. Vonesa në marrjen e vendimeve dhe në procesin e plotësimit të dokumentacionit mund të çojë në manipulimin e tij dhe ngadalësim të zbatimit të detyrimeve ligjore. Një praktikë më e shpejtë dhe e drejtë do të kontribuonte në rritjen e efikasitetit dhe transparencës në procesin e inspektimeve dhe do të siguronte përputhshmërinë me ligjin dhe standardet e punës.

8. Avancimi i kushteve teknike në Inspektoratin Qendror të Punës në Rajonin e Prishtinës

Rekomandohet që Inspektorati Qendror i Punës në Rajonin e Prishtinës të përmirësojë kushtet teknike dhe organizative për të rritur efikasitetin dhe cilësinë e inspektimeve. Kjo përfshin sigurimin e pajisjeve të nevojshme për matjen e temperaturës, cilësisë së ajrit, ndriçimit dhe zhurmës, të cilat janë të domosdoshme për realizimin e inspektimeve të plota dhe të sakta. Gjithashtu, është e rëndësishme të rritet numri i veturave zyrtare, pasi aktualisht janë vetëm 3 vetura për të mbuluar të gjitha inspektimet në Rajonin e Prishtinës, çka kufizon mundësitë për realizimin e inspektimeve në terren. Po ashtu, rekomandohet sigurimi i pajisjeve moderne për dokumentimin e inspektimeve, duke eliminuar përdorimin e telefonave personale të inspektorëve, pasi ky proces ul profesionalizmin dhe rrezikon sigurinë e të dhënave. Për të garantuar mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së inspektorëve, është e nevojshme të sigurohen pajisje personale mbrojtëse që janë të përshtatshme për secilin sektor të inspektuar. Këto përmirësime do të kontribuonin në rritjen e efikasitetit, sigurisë dhe profesionalizmit të Inspektoratit të Punës.



BURIMET

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2002). Ligji Nr. 2002/09 për Inspektoratin e Punës. Marrë nga: <https://gzk.rksgov.net/ActDetail.aspx?ActID=2581>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2008). Ligjit Nr. 03/L-017 për "Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2581>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2009). Ligji Nr. 03/L-019 për Aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2620>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2010). Ligji Nr. 03/L- 212 i Punës. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2735>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2010). Ligji Nr. 03/L-200 për Greva. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2701>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2011). Ligji Nr. 04/-L-011 për Organizimin sindikal në Kosovë. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2754>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2013). Ligji Nr. 04/L-156 për Kontrollin e duhanit. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8665>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2013). Ligji Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8689>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2015). Rregullore për Organizimin e brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Inspektoratin e Punës. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11275>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2016). Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12559>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2018). Ligji Nr. 06/L -085 për Mbrojtjen e sinjalizuesve. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18303>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2019). Ligji Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18684>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2022). Ligji Nr. 08/L-067 për Inspektimet. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=53067>





Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2024). Rregullore nr. 10/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë ekzekutive të Inspektoratit Qendror të Punës. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=53067>

Kërkesë për qasje në dokumente publike, drejtuar zyrës qendrore të Inspektoratit Qendror të Punës (dhjetor 2024).

